



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

*M. 5097/1/MS*

*qdt 21.10.2014*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I STUDIMEVE TË  
KRIMEVE DHE PASOJAVE TË  
KOMUNIZMIT

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Duke marrë në konsideratë se edhe pas njëzet vitesh nga momenti i rënies së diktaturës komuniste, historia e krimeve dhe pasojave të komunizmit në Shqipëri mbetet e papërfshirë ose e përfshirë në mënyrë sipërfaqësore në literaturën shkolllore;

Duke konstatuar mungesën e një baze të mirëfilltë shkencore me studime të këtij objekti dhe institucionalisht të paorganizuar, e cila është bërë e njohur vetëm përmes botimeve spontane në media apo botimeve individuale;

Duke ditur se krijimi i ISKK-së bëri të mundur legjitimimin dhe dokumentimin shkencor të këtij informacioni, i cili duhet të gjejë përfshirjen e tij në sistemin arsimor;

Duke pasur parasysh se ISKK përbën një garanci si pjesë e një rrjeti institucionesh të ngjashme në gjithë Europën, që synojnë zbardhjen e të shkuarës së tyre totalitare dhe duke besuar se suksesi i kësaj përvoje është krejt i mundshëm edhe për ne;

Duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë e bashkëpunimit të ndërsjellë mbi edukimin historik të brezit të ri rreth krimeve dhe pasojave të komunizmit;

Ministria e Arsimit dhe Sportit (në vijim MAS), përfaqësuar nga Z. Plarent Ndreca, në cilësinë e tij si Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit (në vijim ISKK), përfaqësuar nga Z. Agron Tufa, në cilësinë e drejtorit ekzekutiv të institucionit, lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet tyre.

### Neni 1

#### Qëllimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit

ISKK dhe MAS, përmes kësaj marrëveshjeje, kanë si qëllim koordinimin e veprimtarive të përbashkëta institucionale, që synojnë edukimin e nxënësve e studentëve dhe ndërgjegjësimin e shoqërisë mbi krimet e komunizmit dhe shkeljen e të drejtave të njeriut të kryera në Shqipëri gjatë periudhës 1941-1991.

*(Kjo Platformë nisi si Deklarata e Pragës në Nëntor 2008 dhe u mbështet nga Parlamenti European me 2 prill 2009)*

## Neni 2 Angazhimet e palëve

### *ISKK angazhohet:*

1. Të marrë pjesë në grupet e përbashkëta të punës për hartimin e kurrikulave dhe programeve lëndore në arsimin parauniversitar.
2. Të propozojë ndryshime, korrigjime dhe plotësime të programeve ekzistuese, duke ofruar argumentet dhe mbështetjen e duhur informative.
3. Të ofrojë dhe të propozojë produkte të cilat janë pjesë e aktivitetit studimor të ISKK dhe materiale të tjera studimore, të ngjashme, të cilat nuk janë produkt i drejtëpërdejtë i këtij Instituti.
4. Të propozojë metodologji të reja, të cilat do të shoqërojnë hartimin dhe përmirësimin e teksteve shkollore, me qëllim ndërgjegjësimin e nxënësve ndaj kësaj periudhe historike.
5. Të ofrojë mundësi për përdorimin e gjithë informacionit që zotëron dhe do të zotërojë në vazhdim, për studiuesit shkencorë të universiteteve dhe institucioneve të tjera kërkimore.
6. Të sigurojë materiale, botime e publikime për këtë periudhë historike, për të gjitha institucionet arsimore në vend.
7. Të organizojë dhe të realizojë në bashkëpunim me MAS dhe me institucionet e saj të vartësisë veprimtari të përbashkëta, përmes leksioneve, konferencave, seminareve të trajnimit, ekspozitave, performancave, leximeve publike dhe konkurseve, për njohjen e periudhës së genocidit komunist në Shqipëri dhe iniciativat e ndërmarra në nivel europian, që kanë si themel Platformën e Kujtesës e Vetëdijes Europiane, mbi genocidin komunist, shkeljen e të drejtave të njeriut, intolerancën, krimin ekonomik si dhe pasojat e ideologjisë.
8. Të monitorojë mbarëvajtjen e programeve dhe metodologjive të reja të propozuara prej tij, lidhur me çështjen e genocidit komunist në Shqipëri.
9. Të sugjerojë përfshirjen e autorëve (shkrimtarë, poetë, studiues) të mirëstudiuar dhe të argumentuar për t'u përfshirë në kurrikulat e shkollave nëntëvjeçare dhe të mesme, duke bashkëpunuar nëpërmjet përfshirjes në komisione apo grupe pune të ngritura nga MAS për këtë qëllim.
10. Të ofrojë paketa leksionesh didaktike, ilustrativo-edukuese, në lidhje me periudhën e komunizmit.

### **MAS angazhohet:**

1. Të krijojë mundësinë që ISKK të përfaqësohet me specialistë në grupet e punës për hartimin e programeve lëndore në vijimësi të reformës kurrikulare të arsimit parauniversitar.
2. Të krijojë mundësinë që ISKK të përfaqësohet me specialistë lëndorë gjatë momenteve kur rishikohen programet lëndore ekzistuese në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar.
3. Të krijojë hapësira për grupe të përbashkëta shkencore për të diskutuar rreth propozimeve e ISKK për ndryshimin, korrigjimin dhe plotësimin e programeve ekzistuese. Propozimet e ofruara diskutohen në tryeza të rrumbullakëta me ekspertë të fushës së edukimit.
4. Të ngrejë grupe pune për të analizuar metodologjitë e reja të cilat ofrohen nga ISKK për ofrimin e teksteve dhe ndryshimeve kurrikulare.

### **Neni 3**

#### **Koordinimi ndërmjet palëve**

1. Palët bashkëpunojnë përmes grupeve të punës në zbatim të planit të përbashkët vjetor të veprimtarive.
2. Secila palë propozon dhe inicion veprimtari për këtë qëllim, si: ekspozita, konferenca, forume, seminare, sondazhe, botime e publikime të vazhdueshme.
3. Palët mbështesin organizimin e përvitshëm të një aktiviteti të përbashkët më datë 23 gusht: *Dita Europiane e Kujtesës* për të gjitha viktimat e regjimeve totalitare.

### **Neni 4**

#### **Amendimet dhe anulimi i Marrëveshjes**

Palët bëjnë amendime në këtë Marrëveshje, bazuar në pëlqimin e ndërsjellë të tyre, të paraqitura me shkrim dhe të argumentuara.

Marrëveshja mund të anulohet para kohe me kërkesë të njëres prej palëve brenda një afati 3-mujor, në rast se pala tjetër nuk përmbush rregullisht detyrimet e saj apo shkel kushtet e Marrëveshjes.

### **Neni 5**

#### **Kohëzgjatja e Marrëveshjes**

Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë 5-vjeçare dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga përfaqësuesit e dy palëve.

**Neni 6**  
**Dispozita të fundit**

Ky Marrëveshje është hartuar në katër kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe dy të tjera në Institutin e Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit.

**PËR MINISTRINË E ARSIMIT  
DHE SPORTIT**

**PËR INSTITUTIN E STUDIMIT  
TË KRIMEVE DHE PASOJAVE  
TË KOMUNIZMIT**

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

**DREJTORI EKZEKUTIV**

**PLARENT NDRECA**

**AGRON TUFA**

